

Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

për

instalimin e sistemit solar fotovoltaik me fuqi prej 3.5MW mbi
kulmin e objektit industrial Ritek Construction SH.P.K. në
zonën kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit



Maj, 2026

Kompania Ritek Construction SH.P.K. me qëllim të përshpejtim të procedurave për marrjen e pëlqimit mjedisor për instalimin e sistemit solar fotovoltai me fuqi 3.5MW mbi kulmin e objektit të kompanisë së saj, në zonën kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit, ka angazhuar Z. Blert Gjinolli për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Investitori:

Ritek Construction SH.P.K.

Hartuesi i raportit:

Blert Gjinolli, Inxhinier i mjedisit, MSc

PËRMBAJTJA

1	INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	9
1.1	Të dhënat për aplikuesin	9
1.2	Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa	9
1.3	Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e raportit të VNM-së	9
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	9
2.1	Kategoria e projektit të propozuar	9
2.2	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	9
2.3	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit	10
2.3.1	Specifikimet e paneleve fotovoltaike	11
2.3.2	Invertori	11
2.3.3	Kabllo DC	12
2.3.4	Kabllo AC	12
2.3.5	Konstruksioni	13
2.3.6	Trafo dhe linja	13
2.4	Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar	13
2.5	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	14
2.6	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik	15
2.7	Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave	15
2.8	Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	16
2.8.1	Programi i ndërtimit	16
2.8.2	Kohëzgjatja e planifikuar e funksionimit të projektit	17
2.8.3	Koha e mundshme e përfundimit të funksionimit	17
2.8.4	Faza e planifikuar e rehabilitimit pas mbarimit të funksionimit të projektit	17
2.9	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	18
2.10	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave	18
2.11	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin	19

2.12	Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	20
3	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR	20
3.1	Të dhëna për lokacionin ku është planifikuar të zbatohet projekti	20
3.2	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit.....	20
3.3	Distanca me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti	22
3.4	Paraqitja e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit	23
3.5	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	28
3.6	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	29
3.7	Prezantimi i karakteristikave natyrore	32
3.8	Rishikimi i karakteristikave themelore të peisazhit	33
3.9	Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	34
3.10	Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar	34
3.11	Të dhëna për objekte ekzistuese	34
3.12	Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme.....	35
3.13	Të dhënat për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj	35
4	GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR	35
4.1	Përshkrimi i gjendjes aktuale të faktorëve mjedisor.....	35
5	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	39
5.1	Përshkrimi i alternativave të realizueshme	39
5.2	Përshkrimi i arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar.....	39
5.3	Vendndodhja ose rruga	40
5.4	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut.....	40
5.5	Proceset, teknologjia e prodhimit	41
5.6	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit	41
5.7	Plani i lokacionit.....	42
5.8	Lloji dhe përzgjedhja e materialeve për realizimin e projektit	42
5.9	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit	43
5.10	Madhësia e lokacionit ose objektit.....	43
5.11	Vëllimi i prodhimit	43

5.12	Kontrolli i ndotjes.....	43
5.13	Trajtimi i mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar	44
5.14	Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit	45
5.15	Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit.....	45
5.16	Trajnime	46
5.17	Monitorimi	46
5.18	Planet për situata emergjente.....	47
5.19	Demolimi dhe rehabilitimi.....	47
5.20	Plani për menaxhimin e mjedisit	47
5.21	Përshkrimi i alternativave pa veprim	48
6	PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE TË PROJEKTIT NË MJEDIS	48
6.1	Cilësia e ajrit	48
6.2	Cilësia e ujit	49
6.3	Toka.....	50
6.4	Zhurma	51
6.5	Popullsia lokale	51
6.6	Ndikimet socio-ekonomike.....	52
6.7	Ekosistemet dhe gjeologjia.....	53
6.8	Infrastruktura komunale	54
6.8.1	Trafiku	54
6.8.2	Furnizimi me ujë.....	54
6.8.3	Energjia	54
6.8.4	Ujërat e zeza	54
6.8.5	Gjenerimi i mbeturinave	54
6.9	Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peisazhit	55
7	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS.....	56
7.1	Masat e parashikuara me legjislacion	56
7.2	Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	56
7.3	Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit.....	57
7.4	Masa të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis	57
8	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	58
8.1	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	58

8.2	Prezantimi i gjendjes mjedisore para se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku pritet ndikimi mjedisor	58
8.3	Parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis	59
8.4	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të caktuar	59
8.5	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera	59
8.6	Detyrimi për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera	60
8.7	Programi ndërkufitar i monitorimit të ndikimit në mjedis, sipas rastit.....	60
9	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	60
9.1	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit	60
9.2	Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor	61
9.3	Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	61
10	INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT	61
10.1	Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit specifik apo një lloji të caktuar projektesh përmbajnë të dhëna të tjera për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM-së, nëse kërkohen	61
11	BURIMET E TË DHËNAVE	62
11.1	Lista e referimit të burimeve të të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së.....	62
12	SHTOJCA	62
12.1	Përmbledhja jo-teknike e informacionit.....	62

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Njësia kadastrale ku ndodhet objekti i Ritek Construction (burimi: gjeoportali)	21
Figura 2. Lokacioni i objektit industrial Ritek Construction ku do të instalohet sistemi solar fotovoltaik	22
Figura 3. Lokacioni i fabrikës Ritek Construction dhe mjedisi rrethues	23
Figura 4. Përbërja pedologjike e komunës së Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	24
Figura 5. Formacionet gjeologjike në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	26
Figura 6. Rrjeti hidrografik në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	27
Figura 7. Shtrirja e zonave në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	28
Figura 8. Pjerrtësia e terrenit në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	30
Figura 9. Ditët me diell, shi dhe reshje në komunën e Obiliqit	30
Figura 10. Temperatura mesatare dhe reshjet në komunën e Obiliqit	31
Figura 11. Trëndafili i erës	32
Figura 12. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	37
Figura 13. Zonat me rrezikshmëri nga vërshimet në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)	38
Figura 14. Skema e paneleve fotovoltaike mbi kulmin e objektit Ritek Construction	42

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Veçoritë gjeologjike	24
Tabela 2. Vlerat e parametrave të ajrit të matur në stacionin në Obiliq, viti 2024	36

LISTA E SHKURTESAVE

AC – Rrymë alternative

AME – Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave

AMMK – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

DC – Rrymë e drejtë

KEDS – Kompania Kosovare për Distribuiim me Energji Elektrike

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjetlësit

kV – Kilovolt

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

PMM – Plani për Menaxhimin e Mjedisit

SHPK – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

TC – Termocentrali

1 INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1 Të dhënat për aplikuesin

Emri i kompanisë: Ritek Construction SH.P.K.

Adresa: Milloshevë, Obiliq

1.2 Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa

Titulli i plotë: Instalimi i sistemit solar fotovoltaik me fuqi prej 3.5 MW mbi kulmin e objektit industrial Ritek Construction SH.P.K.

Vendndodhja: Zona kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit

1.3 Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e raportit të VNM-së

Udhëheqësi i ekipit: Blert Gjinolli, Inxhinier i Mjedisit, MSc (Person fizik i licencuar për hartimin e raporteve të VNM-së); Nr. i licencës: 14/20

Ekipi profesional: Diellza Osmanaj, Inxhinier e Mjedisit, Aurita Gallapeni, Inxhinier e Mjedisit

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1 Kategoria e projektit të propozuar

Projekti i propozuar për instalimin e sistemit solar fotovoltaik në kulmin e objektit industrial Ritek Construction SH.P.K. bën pjesë në kategorinë e projekteve energjetike, përkatësisht në nënkategorinë e projekteve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Ky lloj projekti synon shfrytëzimin e energjisë diellore për prodhimin e energjisë elektrike, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të pastra në miksin energjetik.

Bazuar në legjislacionin në fuqi për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kosovë, ky projekt klasifikohet në kategorinë e projekteve që mund të kenë ndikim në mjedis. Projekti përfshin instalimin e paneleve fotovoltaike në kulmin e objektit industrial, strukturat mbajtëse për panelet, inverterët për konvertimin e energjisë, kabllo dhe pajisjet elektrike përcjellëse, si dhe lidhjen e sistemit me rrjetin ekzistues të energjisë elektrike. Gjithashtu, mund të përfshihen punime të kufizuara për përshtatjen e kulmit, instalimin e sistemit të montimit dhe integrimin teknik të sistemit në infrastrukturën ekzistuese të objektit.

Duke qenë se projekti bazohet në përdorimin e një burimi të ripërtëritshëm të energjisë dhe nuk përfshin procese të djegies apo emetime të drejtpërdrejta ndotëse gjatë operimit, ai konsiderohet si një ndërhyrje me ndikim pozitiv në mjedis. Projekti kontribuon në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe mbështet tranzicionin drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

2.2 Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Punët përgatitore për realizimin e projektit përfshijnë një sërë aktiviteteve teknike dhe organizative që sigurojnë zbatimin e sigurt dhe efikas të projektit.

Fillimisht, realizohet vlerësimi teknik i objektit ekzistues, duke përfshirë analizën e qëndrueshmërisë strukturore të kulmit për të verifikuar nëse ai mund të përballojë ngarkesën shtesë nga panelet fotovoltaike dhe strukturat mbajtëse. Në këtë fazë kryhen edhe matjet e orientimit dhe pjerrtësisë së kulmit, si dhe analiza e ekspozimit ndaj rrezatimit diellor me qëllim optimizimin e vendosjes së paneleve. Paralelisht, përgatitet projekti teknik (dizajni) i sistemit fotovoltaik, i cili përfshin dimensionimin e kapacitetit të sistemit, përzgjedhjen e pajisjeve (panelet, inverterët, kabllot, sistemet e montimit), si dhe skemat elektrike për lidhjen me rrjetin ekzistues të energjisë elektrike. Punët përgatitore përfshijnë edhe organizimin e kantierit të punës, që në këtë rast është i kufizuar në hapësirën e kulmit dhe zonat ndihmëse brenda fabrikës. Kjo përfshin transportin dhe magazinimin e përkohshëm të materialeve dhe pajisjeve, sigurimin e qasjes së sigurt në kulm, si dhe vendosjen e masave të mbrojtjes për punëtorët (p.sh. pajisje mbrojtëse personale, sisteme kundër rënies nga lartësia).

Në këtë fazë mund të realizohen edhe punime të vogla përgatitore në kulm, si pastrimi i sipërfaqes, riparime të nevojshme apo përf forcime lokale, nëse kërkohen nga analiza strukturore. Në tërësi, punët përgatitore janë me ndikim minimal në mjedis, pasi zhvillohen brenda një objekti ekzistues dhe nuk kërkojnë ndërhyrje të konsiderueshme në tokë apo në mjedisin përreth.

Objekti industrial, në kulmin e të cilit do të instalohet sistemi solar fotovoltaik me fuqi prej 3.5 MW, ndodhet në zonën kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit, përkatësisht në ngastrën kadastrale P-72614041-00138-3, me një sipërfaqe prej 41,881 metrash katrorë.

2.3 Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Projekti i propozuar konsiston në instalimin dhe operimin e një sistemi solar fotovoltaik me kapacitet të instaluar prej rreth 3,500 kWp (3.5 MWp), i cili do të vendoset në kulmin e objektit industrial Ritek Construction SH.P.K. Sistemi është projektuar për të prodhuar energji elektrike nga rrezatimi diellor dhe për ta shfrytëzuar atë kryesisht për nevojat e konsumit të brendshëm të fabrikës, me mundësi të injektimit të tepricave në rrjetin elektrik, në përputhje me kushtet e operatorit të rrjetit.

Sipas të dhënave teknike të projektit, parashihet instalimi i rreth 5,600 paneleve solare monokristaline me fuqi individuale prej 625 Wp, që përbëjnë komponentin kryesor të gjenerimit të energjisë. Panelet do të vendosen mbi strukturë mbajtëse metalike të përshtatur për kulme, duke siguruar orientim dhe pjerrtësi optimale për maksimizimin e prodhimit të energjisë.

Energjia elektrike e prodhuar nga panelet (rrymë DC) do të konvertohet në rrymë alternative (AC) përmes 10 inverterëve të tipit SG350HX-P2 (SUNGROW), të cilët janë të shpërndarë në mënyrë të tillë që të optimizohet performanca dhe të minimizohen humbjet. Sistemi do të përfshijë gjithashtu matës inteligjent të energjisë për monitorimin në kohë reale të prodhimit dhe konsumit të energjisë, si dhe sistem monitorimi për kontroll dhe menaxhim të performancës së instalimit.

Infrastruktura elektrike e projektit përfshin kabllot DC dhe AC, ndërprerësit, ormanët elektrikë dhe pajisjet mbrojtëse, të cilat sigurojnë transmetimin e sigurt dhe efikas të energjisë nga panelet drejt inverterëve dhe më tej në rrjetin e brendshëm të objektit. Gjithashtu, projekti përfshin instalimin e transformatorëve dhe linjave përcjellëse, të nevojshme për integrimin e sistemit në rrjetin elektrik.

Gjatë funksionimit, sistemi fotovoltaiik operon në mënyrë automatike dhe kërkon mirëmbajtje minimale, që përfshin pastrimin periodik të paneleve, kontrollin e lidhjeve elektrike dhe monitorimin e performancës së inverterëve dhe pajisjeve të tjera.

Në aspektin operacional, projekti nuk gjeneron emetime direkte në ajër, ujë apo tokë dhe nuk prodhon zhurmë të konsiderueshme, përveç një niveli shumë të ulët nga inverterët. Për këtë arsye, funksionimi i tij konsiderohet me ndikim shumë të ulët në mjedis, ndërkohë që kontribuon në reduktimin e konsumit të energjisë nga burimet fosile dhe uljen e emetimeve të gazeve serrë.

2.3.1 Specifikimet e paneleve fotovoltaike

Moduli fotovoltaiik është pajisja prodhuese e sistemit solar fotovoltaiik. Kjo pajisje përbëhet nga qelitë fotovoltaike të montuara në një kornizë. Qelitë fotovoltaike përbëhen nga materiali gjysmë përçues përmes së cilit bëhet shndërrim i energjisë së diellit në rrymë elektrike të vazhdueshme. Këto qeli lidhen në seri me njëra tjetrën, duke formuar një modul fotovoltaiik. Modulet fotovoltaike të zakonshme janë me 60 apo 72 qeli. Modulet fotovoltaike duhet të jenë të prodhuara sipas standardit EN 50521. Karakteristikat e moduleve fotovoltaike përcaktohen nga prodhuesi në kushte standarde të testimit. Meqenëse modulet fotovoltaike përbëjnë pjesën më të madhe të investimit, duhet të sigurohet kualiteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Për këtë arsye, modulet fotovoltaike duhet të jenë të çertifikuara sipas instituteve testuese të njohura.

Do të instalohen panele solare monokristaline me fuqi nominale prej 625 Wp për njësi, të prodhuara nga kompania Trina . Në total, sistemi përbëhet nga rreth 5,600 panele, duke arritur një kapacitet të instaluar prej afërsisht 3,500 kWp (3.5 MWp).

Teknologjia e paneleve (me qeliza të ndara në gjysmë) mundëson performancë më të lartë krahasuar me panelet tradicionale, pasi redukton humbjet rezistive dhe përmirëson sjelljen e panelit në kushte të pjesshme të hijezimit. Panelet monokristaline karakterizohen nga efikasiteti i lartë i konvertimit të energjisë diellore në energji elektrike dhe stabilitet i mirë gjatë operimit në kushte të ndryshme klimatike.

2.3.2 Invertori

Invertori duhet të bëjë shndërrimin e rrymës së vazhdueshme të prodhuar nga moduli fotovoltaiik në rrymë alternative me frekuencë dhe tension të përshtatshëm për sistemin elektrik ku është implementuar sistemi solar fotovoltaiik. Një inverter kryen këto funksione në sistemin solar fotovoltaiik: shndërron rrymën e vazhdueshme të prodhuar nga modulet fotovoltaike në rrymë alternative, përmes gjurmuesit përshtatë pikën e punës së inverterit në pikën e fuqisë maksimale të modulit fotovoltaiik, monitoron dhe regjistron të dhënat e prodhimit të sistemit solar fotovoltaiik. Parimi i punës varet në elementet e elektronikës energjetike. Këto elemente i mundësojnë inverterit të punojë në kushte optimale. Për t'a bërë këtë përdoret një qark elektronik i cili e përshtatë tensionin në atë mënyrë që invertori të punojë në pikën në të cilën vargu apo grupi i moduleve fotovoltaike arrinë fuqinë maksimale. Ky njihet si gjurmues i pikes më të lartë të fuqisë. Ky gjurmues siguron që fuqia më e madhe e mundshme transferohet në rrjetin elektrik apo ngarkesën e ndërtesës.

Sistemi solar fotovoltaiik parashikon përdorimin e 10 inverterëve të tipit SG350HX-P2, prodhues SUNGROW. Funksioni kryesor i inverterëve në këtë projekt është konvertimi i rrymës së drejtë (DC) të prodhuar nga panelet fotovoltaike në rrymë alternative (AC) të përdorshme për konsum në fabrikë dhe/ose për injektim në rrjetin elektrik.

2.3.3 Kabllot DC

Përmes kabllimit DC, bëhet lidhja elektrike e moduleve fotovoltaike me pjesën tjetër të sistemit solar fotovoltaik. Kabllimi DC duhet të bëhet sipas standardit IEC 60364-7-712 dhe 60364-5-52 dhe duke respektuar udhëzimet shtesë të furnizuesit. Pikat kyçe që duhet pasur parasysh gjatë kabllimit DC janë: fiksimi i sigurt, kontakti i sigurt dhe i qëndrueshëm, instalim i qëndrueshëm ndaj motit, përballimi i një brezi të gjerë të temperaturave (-55°C deri 125°C) dhe rezistenca ndaj rrezeve ultra vjollcë. Kabllot me një bërthamë dhe izolim të dyfishtë ka rezultuar të jenë të qëndrueshëm dhe konsiderohen si zgjidhje e përshtatshme për kabllimin DC. Këto kabllot njihen si kabllot solare dhe janë të klasifikuara si PV1-F. Në rast se nuk respektohen këto karakteristika mund të kemi lidhje të dobët, hark elektrik, rrezik nga zjarri etj. Sipas IEC 60364-5-52 kabllimi nuk duhet të dëmtohet nga lidhëset e kablllove. Kujdes i madh duhet të bëhet gjatë lidhjes së kablllove të vargut apo kablllove tjera DC. Kjo në mënyrë që të shmangen harqet të cilat mund të shkaktojnë rrezik nga zjarri. Në rast se nuk përdoren konektorët, për të iu shmangur rrezikut të përmendur më lartë, kyçja duhet të bëhet sipas standardit DIN 46228. Nëse përdoren konektorët, duhet të sigurohemi që konektorët e zgjedhur i janë përmbajtur kërkesave të sigurisë sipas IEC 62852:2014. Nuk ka ndonjë formë fizike të standardizuar të konektorëve. Sipas IEC 60364-7-712 kabllimi duhet të bëhet në atë mënyrë që gjatësitë e përçuesve dhe sipërfaqja e krijuar në mes tyre të jenë më të vogla të mundshme. Në rastet kur nuk mund të respektohen të dyja këto kushte, prioritet ka mbajtja e sipërfaqes së krijuar në mes të përçuesve në sa më të vogël të mundshme. Kjo në mënyrë që të zvogëlohet tensioni i shkakuar nga goditjet elektrike.

Për projektin do të përdoren kabllot DC me seksion 4 mm², të prodhuara nga kompania ICEL. Kabllot janë të dimensionuara në përputhje me kapacitetin e sistemit prej rreth 3.5 MW, duke siguruar transmetim të qëndrueshëm të energjisë dhe minimizim të humbjeve elektrike.

Gjatë instalimit, kabllot vendosen në mënyrë të organizuar dhe të mbrojtur, duke përdorur kanale kablllore ose sisteme mbajtëse, për të shmangur dëmtimet mekanike dhe për të garantuar siguri maksimale në operim.

Në tërësi, përdorimi i kablllove DC të standardizuara dhe të çertifikuara siguron funksionim të besueshëm të sistemit dhe minimizon rreziqet teknike dhe mjedisore gjatë operimit të projektit.

2.3.4 Kabllot AC

Sistemi solar fotovoltaik i propozuar përfshin edhe rrjetin e kablllove të rrymës alternative (AC), të cilat shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike nga inverterët drejt rrjetit të brendshëm të fabrikës dhe/ose drejt pikës së lidhjes me rrjetin elektrik.

Këto kabllot lidhin inverterin me rrjetin elektrik përmes pajisjeve mbrojtëse. Dimensionimi i kabllot AC duhet të bëhet sipas VDE 0298 pjesa e 4, sipas së cilës kabllot alternative duhet të ketë kapacitet të bartë rrymë më të lartë se rryma maksimale të cilën mund ta prodhojë inverteri. Kjo vlerë gjendet në fletën e të dhënave të inverterit. Sipas DIN 18015, për mbrojtje ndaj devijimeve të mundshme të tensionit, gjatë kalkulimit të seksionit të përçuesit alternativ mund të llogaritet një rënie e tensionit prej 3%. Në rast të inverterëve trefazorë, kyçja në nivelin e ulët të tensionit duhet të bëhet me kabllot 5 fije. Për inverterët një fazorë, kyçja duhet të bëhet me kabllot 3 fije. Kabllot mund të jenë të tipit NYM, NYY ose NYCWY.

2.3.5 Konstruksioni

Konstruksioni i sistemit fotovoltaiik përbën strukturën mbajtëse mbi të cilën vendosen dhe fiksohen panelet solare në kulmin e objektit industrial. Ky komponent është thelbësor për sigurimin e stabilitetit mekanik, orientimit optimal dhe jetëgjatësisë së instalimit. Konstruksioni përfshin elemente metalike mbajtëse, ndër të cilat profile metalike të tipit U (U profil) dhe elemente lidhëse (lidhëse fundore dhe të mesme), të cilat shërbejnë për fiksimin e paneleve në strukturë.

Funksioni kryesor i konstruksionit është të sigurojë mbajtjen e paneleve në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, duke minimizuar rrezikun e dëmtimeve mekanike dhe duke garantuar performancë optimale.

Gjatë instalimit, konstruksioni fiksohet në mënyrë të kontrolluar në kulm, duke respektuar integritetin e tij strukturor dhe duke shmangur dëmtimet apo infiltrimin e ujit. Të gjitha elementet lidhëse janë të standardizuara dhe të çertifikuara për përdorim në sisteme fotovoltaike.

Në tërësi, konstruksioni i projektit është projektuar për të siguruar stabilitet afatgjatë, siguri në operim dhe përshtatshmëri me kushtet ekzistuese të objektit industrial, me ndikim minimal në mjedis gjatë fazës së instalimit dhe operimit.

2.3.6 Trafo dhe linja

Sistemi fotovoltaiik i propozuar përfshin edhe komponentët e nevojshëm për transformimin dhe transmetimin e energjisë elektrike, konkretisht transformatorët (trafo) dhe linjat përcjellëse, të cilat mundësojnë integrimin e sistemit në rrjetin elektrik të fabrikës dhe/ose në rrjetin publik.

Projekti parashikon instalimin e dy transformatorëve me kapacitet 1600 kVA secili, si dhe linjat dhe kthinat përkatëse për shpërndarjen e energjisë. Këta transformatorë shërbejnë për ngritjen ose përshtatjen e nivelit të tensionit të energjisë elektrike të prodhuar nga sistemi fotovoltaiik, në mënyrë që ajo të jetë e përshtatshme për përdorim në rrjetin e brendshëm dhe për injektim në rrjetin e shpërndarjes.

Energjia elektrike, pasi konvertohet nga DC në AC përmes inverterëve, transmetohet përmes kabllave AC drejt transformatorëve, ku bëhet transformimi i tensionit sipas kërkesave teknike të rrjetit. Më pas, përmes linjave përcjellëse, energjia shpërndahet drejt pikës së konsumit.

2.4 Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar

Në rastin e sistemit solar fotovoltaiik, procesi i prodhimit nuk përfshin lëndë të para në kuptimin klasik industrial, por bazohet në shfrytëzimin e rrezatimit diellor si burim primar energjie. Prosesi fillon me rrezatimin diellor që bie mbi sipërfaqen e paneleve fotovoltaike të instaluara në kulmin e objektit industrial. Intensiteti i këtij rrezatimi ndikohet nga kushtet klimatike, orientimi dhe pjerrtësia e paneleve, si dhe nga periudha kohore gjatë ditës dhe vitit.

Panelet fotovoltaike, të përbëra nga qeliza monokristaline, konvertojnë energjinë diellore në energji elektrike në formë të rrymës së drejtë përmes efektit fotovoltaiik. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë ekspozimit ndaj dritës diellore dhe nuk përfshin procese mekanike apo kimike që gjenerojnë ndotje. Energjia e prodhuar transmetohet përmes kabllave DC drejt inverterëve, ku panelet janë të lidhura në vargje për të optimizuar tensionin dhe rrymën.

Në inverterë realizohet konvertimi i rrymës së drejtë në rrymë alternative, e cila është forma standarde e energjisë elektrike për përdorim në instalimet industriale dhe për shpërndarje në rrjet. Ky proces është plotësisht i automatizuar dhe i kontrolluar për të siguruar efikasitet maksimal të sistemit. Energjia e konvertuar në rrymë alternative transmetohet më tej përmes kabllove AC dhe pajisjeve mbrojtëse drejt transformatorëve, ku bëhet përshtatja e nivelit të tensionit në përputhje me kërkesat e rrjetit elektrik.

Pas transformimit, energjia shpërndahet për konsum të brendshëm të fabrikës dhe, në rastet kur prodhimi tejkalon kërkesën, mund të injektohet në rrjetin elektrik. I gjithë sistemi funksionon në mënyrë të integruar dhe monitorohet përmes pajisjeve inteligjente që mundësojnë kontroll në kohë reale të prodhimit dhe performancës së tij.

Produkti përfundimtar i këtij procesi është energjia elektrike e pastër në formë të rrymës alternative, e gatshme për përdorim në proceset industriale ose për furnizim në rrjet. Ky proces karakterizohet nga mungesa e emetimeve ndotëse, përdorimi i burimeve të ripërtëritshme dhe kërkesa minimale për ndërhyrje gjatë operimit, duke e bërë atë një zgjidhje të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit.

2.5 Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Zbatimi dhe operimi i projektit për instalimin e sistemit solar fotovoltaiik kërkon një sërë burimesh materiale, teknike dhe njerëzore, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e tij të qëndrueshëm dhe efikas. Burimi kryesor natyror për operimin e këtij projekti është rrezatimi diellor, i cili përbën inputin bazë për prodhimin e energjisë elektrike dhe nuk konsumohet në kuptimin klasik, duke qenë një burim i ripërtëritshëm dhe i pashtershëm.

Nga aspekti i burimeve materiale, projekti kërkon komponentë kryesorë si panelet fotovoltaike, inverterët, kabllo DC dhe AC, strukturat mbajtëse metalike, si dhe pajisjet elektrike përcjellëse dhe mbrojtëse. Sa i përket burimeve energjetike gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit, kërkohet përdorimi i energjisë elektrike për pajisjet e punës dhe i karburanteve për transportin e materialeve dhe pajisjeve. Megjithatë, gjatë fazës së operimit, sistemi nuk kërkon furnizim me lëndë djegëse, pasi funksionon plotësisht mbi bazën e energjisë diellore.

Në aspektin e burimeve ujore, kërkesat janë minimale dhe lidhen kryesisht me pastrimin periodik të paneleve për të ruajtur efikasitetin e tyre. Konsumi i ujit në këtë fazë është i kufizuar dhe realizohet në intervale të caktuara, në varësi të kushteve atmosferike dhe nivelit të ndotjes së sipërfaqes së paneleve.

Burimet njerëzore përfshijnë staf teknik të specializuar për fazën e instalimit, si dhe një numër të kufizuar punëtorësh për operim dhe mirëmbajtje gjatë fazës së operimit të projektit. Pas përfundimit të instalimit, kërkesat për staf janë minimale dhe lidhen kryesisht me monitorimin dhe mirëmbajtjen periodike të sistemit.

Në tërësi, projekti karakterizohet nga kërkesa relativisht e ulët për burime gjatë fazës së operimit, duke u mbështetur kryesisht në një burim natyror të ripërtëritshëm dhe duke minimizuar përdorimin e resurseve të tjera, çka e bën atë një zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase nga aspekti mjedisor dhe ekonomik.

2.6 Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik

Procesi teknologjik i prodhimit të energjisë në një sistem solar fotovoltaiik karakterizohet nga mungesa e proceseve të djegies dhe transformimeve kimike, për rrjedhojë gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë fazës së operimit është minimal.

Gjatë fazës së instalimit, mbeturinat që mund të gjenerohen janë kryesisht mbetje ndërtimore dhe paketimi, si karton, plastikë, paleta druri, mbetje metalike nga strukturat mbajtëse dhe copa kabllorësh. Këto mbetje janë zakonisht të një sasive të moderuar dhe mund të menaxhohen përmes grumbullimit selektiv dhe dërgimit për riciklim ose trajtim të autorizuar. Duke qenë se instalimi zhvillohet në një objekt ekzistues (kulm fabrike), nuk priten mbetje nga gjermime apo punime të mëdha tokësore.

Sa i përket emetimeve gjatë instalimit, ato lidhen kryesisht me përdorimin e pajisjeve dhe transportin e materialeve, që mund të gjenerojnë emetime të përkohshme në ajër (pluhur dhe gazra nga djegia e karburanteve), si dhe nivele të kufizuara zhurme. Këto ndikime janë afatshkurtra dhe të lokalizuara.

Gjatë fazës së operimit, sistemi fotovoltaiik nuk gjeneron mbeturina në mënyrë të vazhdueshme, pasi nuk përfshin procese prodhuese me lëndë të para të konsumueshme. Mbeturina të rastësishme mund të krijohen vetëm gjatë mirëmbajtjes, si p.sh. pjesë të dëmtuara të kabllorëve, komponentë të vegjël elektrikë apo, në raste të rralla, panele të dëmtuara. Këto klasifikohen si mbetje elektrike dhe elektronike dhe duhet të trajtohen në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në aspektin e emetimeve gjatë operimit, sistemi nuk prodhon emetime në ajër, ujë apo tokë, pasi energjia prodhohet përmes shfrytëzimit të rrezatimit diellor pa procese djegieje. Niveli i zhurmës është shumë i ulët dhe lidhet vetëm me funksionimin e inverterëve dhe transformatorëve, i cili zakonisht është brenda kufijve të lejuar për ambiente industriale.

Në përfundim, gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve nga ky projekt është shumë i ulët dhe i kufizuar kryesisht në fazën e instalimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa gjatë operimit ndikimet janë minimale, duke e bërë këtë teknologji një nga opsionet më të favorshme nga pikëpamja mjedisore.

2.7 Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave të gjeneruara nga projekti i instalimit dhe operimit të sistemit solar fotovoltaiik bazohet në parimet e minimizimit, ndarjes në burim, ripërdorimit dhe riciklimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë për menaxhimin e mbeturinave. Duke qenë se projekti nuk përfshin procese industriale prodhuese, llojet dhe sasisë të mbeturinave janë të kufizuara dhe kryesisht të natyrës jo të rrezikshme, me përjashtim të disa komponentëve elektrikë.

Gjatë fazës së instalimit, mbeturinat kryesore përfshijnë materiale paketimi si karton, plastikë dhe paleta druri, si dhe mbetje të vogla metalike dhe copa kabllorësh. Këto mbeturina do të ndahen në burim dhe do të depozitohen përkohësisht në zona të caktuara brenda objektit, për t'u dorëzuar më pas tek operatorë të licencuar për riciklim ose trajtim. Materialet si kartoni, plastika dhe metalet kanë potencial të lartë riciklimi dhe do të orientohen drejt zinxhirit të riciklimit.

Mbetjet nga kabllot dhe komponentët elektrikë klasifikohen si mbetje elektrike dhe elektronike dhe do të trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore për këtë kategori. Këto mbetje do të grumbullohen

veçmas dhe do të dorëzohen tek kompani të autorizuar për trajtimin dhe riciklimin e tyre, ku bëhet ndarja e materialeve përbërëse si bakri, alumini dhe plastika.

Gjatë fazës së operimit, gjenerimi i mbeturinave është minimal dhe lidhet kryesisht me aktivitetet e mirëmbajtjes. Në raste të rralla mund të krijohen mbetje nga zëvendësimi i komponentëve të dëmtuar, si inverterë, kablllo apo panele fotovoltaike. Panelet e dëmtuara përbëhen kryesisht nga xhami, alumin dhe materiale gjysmëpërçuese, dhe mund të riciklohen përmes proceseve të specializuara që mundësojnë rikuperimin e materialeve të vlefshme. Këto do të trajtohen nga operatorë të licencuar në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore.

Sa i përket mbetjeve potencialisht të rrezikshme, si vajrat izolues të transformatorëve (nëse aplikohen), këto do të menaxhohen në përputhje me rregullat për mbetjet e rrezikshme, duke përfshirë ruajtjen në kushte të sigurta, transportin dhe trajtimin nga operatorë të licencuar.

Asgjësimi i mbeturinave do të konsiderohet vetëm si opsion i fundit, për mbetjet që nuk mund të riciklohen apo ripërdoren. Në këto raste, mbeturinat do të dërgohen në deponi të licencuara, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore.

Në tërësi, teknologjia dhe qasja e menaxhimit të mbeturinave për këtë projekt synon minimizimin e ndikimeve në mjedis përmes riciklit dhe trajtimit të kontrolluar, duke siguruar përputhshmëri me legjislacionin dhe praktikën më të mira mjedisore.

2.8 Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Zbatimi i projektit për instalimin e sistemit solar fotovoltaike në kulmin e fabrikës parashihet të realizohet në disa faza të organizuara, duke filluar nga përgatitja teknike dhe administrative deri në instalimi dhe vënia në funksion e sistemit.

2.8.1 Programi i ndërtimit

Programi i ndërtimit të sistemit solar fotovoltaike në kulmin e objektit industrial është i organizuar në disa faza të njëpasnjëshme, të cilat sigurojnë realizimin efikas dhe të sigurt të projektit brenda afatit të parashikuar.

Fillimisht zhvillohet faza përgatitore, e cila përfshin finalizimin e projektit teknik, sigurimin e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme, si dhe organizimin logjistik të kantierit. Në këtë fazë planifikohet furnizimi me pajisje dhe materiale, organizohet transporti dhe përcaktohen procedurat e sigurisë dhe menaxhimit të punimeve.

Pas kësaj vijon faza e mobilizimit në terren, ku bëhet pranimi i pajisjeve dhe materialeve, organizimi i hapësirave për magazinim të përkohshëm dhe sigurimi i qasjes në kulm për realizimin e punimeve. Në këtë fazë vendosen edhe masat e nevojshme të sigurisë në punë.

Faza kryesore e ndërtimit përfshin instalimin e strukturës mbajtëse metalike në kulm, e cila shërben si bazë për vendosjen e paneleve fotovoltaike. Më pas realizohet montimi i paneleve, lidhja e tyre në vargje dhe instalimi i kablllove DC që i lidhin panelet me inverterët.

Në vijim, instalohen inverterët dhe pajisjet e tjera elektrike, përfshirë kabllot AC, ndërprerësit dhe ormanët elektrikë. Pas kësaj realizohet integrimi i sistemit me transformatorët dhe linjat elektrike, duke mundësuar lidhjen me rrjetin e brendshëm të objektit dhe, sipas rastit, me rrjetin publik të energjisë elektrike. Faza përfundimtare përfshin testimin dhe komisionimin e sistemit, ku verifikohet funksionimi i të gjithë komponentëve, bëhen matjet përkatëse dhe sistemi vihet në operim. Gjatë kësaj faze realizohet edhe trajnimi i stafit për operim dhe mirëmbajtje, si dhe dorëzimi teknik i projektit.

2.8.2 Kohëzgjatja e planifikuar e funksionimit të projektit

Në tërësi, programi i ndërtimit është i planifikuar të realizohet brenda një periudhe relativisht të shkurtër, zakonisht 3 deri në 6 muaj, duke minimizuar ndërprerjet në aktivitetin e fabrikës dhe duke siguruar zbatim në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë.

Duke u bazuar në specifikat teknike të projektit dhe në përbërjen e sistemit fotovoltaiik, jetëgjatësia e pritshme e projektit vlerësohet të jetë rreth 25 deri në 30 vjet

2.8.3 Koha e mundshme e përfundimit të funksionimit

Koha e mundshme e përfundimit të funksionimit të projektit lidhet drejtpërdrejt me jetëgjatësinë teknike dhe ekonomike të komponentëve kryesorë të sistemit fotovoltaiik. Bazuar në karakteristikat e pajisjeve të parashikuara, veçanërisht të paneleve fotovoltaike monokristaline, projekti pritët të ketë një jetë funksionale prej rreth 25 deri në 30 vjet nga momenti i vënies në operim.

Në përfundim të kësaj periudhe, performanca e sistemit pritët të ulet gradualisht për shkak të degradimit natyror të paneleve dhe komponentëve të tjerë, duke bërë që operimi i mëtejshëm të mos jetë më ekonomishtë i favorshëm pa ndërhyrje shtesë. Për këtë arsye, përfundimi i funksionimit të projektit parashikohet të ndodhë pas përfundimit të ciklit të tij jetësor teknik, përkatësisht pas rreth 25–30 viteve operim.

2.8.4 Faza e planifikuar e rehabilitimit pas mbarimit të funksionimit të projektit

Pas përfundimit të jetës funksionale të sistemit solar fotovoltaiik, parashihet realizimi i fazës së çmontimit dhe rehabilitimit, me qëllim kthimin e hapësirës në një gjendje të sigurt dhe funksionale, si dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore.

Kjo fazë fillon me çkyçjen e sistemit nga rrjeti elektrik dhe sigurimin e të gjitha kushteve të nevojshme për ndërhyrje të sigurt. Në vijim realizohet çmontimi i paneleve fotovoltaike, strukturave mbajtëse, inverterëve, kabllave dhe pajisjeve të tjera elektrike. Të gjitha komponentët hiqen në mënyrë të kontrolluar për të shmangur dëmtimet dhe për të mundësuar ripërdorimin ose riciklimin e tyre. Duke qenë se projekti është i vendosur në kulmin e një objekti ekzistues dhe nuk përfshin ndërhyrje në tokë, rehabilitimi i sipërfaqes është minimal. Ai konsiston kryesisht në largimin e të gjitha elementeve të instalimit dhe rikthimin e kulmit në gjendjen e tij fillestare ose në një gjendje të sigurt për përdorim të mëtejshëm. Nëse gjatë instalimit janë kryer ndërhyrje të vogla në strukturën e kulmit, ato do të riparohen sipas nevojës.

Në tërësi, faza e rehabilitimit është e menaxhueshme dhe me ndikim të ulët në mjedis, duke qenë se shumica e materialeve mund të riciklohen dhe nuk kërkohen ndërhyrje të mëdha fizike në hapësirë. Ky proces siguron mbylljen e ciklit jetësor të projektit në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

2.9 Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Realizimi dhe operimi i projektit për instalimin e sistemit solar fotovoltaik kërkon një infrastrukturë mbështetëse të kufizuar, duke qenë se projekti zhvillohet në kulmin e një objekti ekzistues industrial dhe shfrytëzon në masë të madhe kapacitetet ekzistuese.

Infrastruktura kryesore përfshin vetë objektin e fabrikës, konkretisht kulmin e tij, i cili shërben si platformë për instalimin e paneleve fotovoltaike dhe strukturave mbajtëse. Kulmi duhet të plotësojë kërkesat teknike dhe strukturore për të përballuar ngarkesën shtesë nga sistemi fotovoltaik dhe për të siguruar qasje të sigurt për instalim dhe mirëmbajtje.

Në aspektin elektrik, infrastruktura përfshin rrjetin e brendshëm të shpërndarjes së energjisë në fabrikë, i cili do të përdoret për integrimin e energjisë së prodhuar. Projekti kërkon gjithashtu instalimin e pajisjeve shtesë si inverterët, kabllot DC dhe AC, ormanët elektrikë dhe pajisjet mbrojtëse, si dhe transformatorët dhe linjat përcjellëse për përshtatjen dhe transmetimin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e rrjetit.

Për fazën e ndërtimit dhe instalimit, nevojitet infrastruktura ndihmëse si qasje rrugore për transportin e pajisjeve dhe materialeve, hapësira për magazinim të përkohshëm brenda objektit ose në afërsi të tij, si dhe furnizim me energji elektrike për përdorimin e pajisjeve të punës. Këto kërkesa janë minimale dhe zakonisht përmbushen nga infrastruktura ekzistuese e fabrikës.

Sa i përket infrastrukturës së komunikimit dhe monitorimit, sistemi do të përfshijë pajisje për monitorim në kohë reale të prodhimit dhe performancës, të cilat mund të lidhen me rrjetin e brendshëm ose me sisteme të kontrollit në distancë.

Në aspektin e furnizimit me ujë, kërkesat janë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me pastrimin periodik të paneleve, duke përdorur burimet ekzistuese të objektit. Nuk kërkohet ndërtimi i infrastrukturës së re ujore apo kanalizimeve.

Në tërësi, projekti mbështetet kryesisht në infrastrukturën ekzistuese të objektit industrial, me nevojë minimale për zhvillim të infrastrukturës së re, çka kontribuon në reduktimin e ndikimeve mjedisore dhe kostove të realizimit.

2.10 Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Për zbatimin e projektit për instalimin e sistemit solar fotovoltaik në kulmin e fabrikës nuk parashihen aktivitete shtesë të natyrës së ndërtimit të kampeve, rezidencave apo objekteve të përkohshme për akomodimin e punëtorëve. Kjo lidhet me faktin se projekti zhvillohet në një zonë industriale ekzistuese dhe realizohet në një objekt funksional, ku infrastruktura bazë dhe kushtet e nevojshme janë tashmë të disponueshme.

Gjatë fazës së instalimit mund të nevojiten vetëm aktivitete të kufizuara mbështetëse, si organizimi i hapësirave për magazinim të përkohshëm të pajisjeve dhe materialeve, vendosja e mjeteve ndihmëse për ngritje dhe transport në kulm, si dhe sigurimi i kushteve për punë të sigurt për ekipin teknik. Këto aktivitete realizohen brenda hapësirës së objektit ekzistues dhe nuk kërkojnë ndërtim të strukturave të reja të përhershme apo të përkohshme.

Punëtorët dhe stafi teknik pritet të jenë kryesisht lokalë dhe nuk kërkojnë akomodim në vendin e projektit. Gjithashtu, nuk parashikohet ndërtimi i infrastrukturës shtesë sociale apo shërbimeve ndihmëse, pasi këto mund të sigurohen nga kapacitetet ekzistuese të fabrikës dhe zonës përreth.

Në tërësi, projekti nuk kërkon zhvillim të aktiviteteve të tjera të rëndësishme përtej atyre të lidhura drejtpërdrejt me instalimin dhe operimin e sistemit fotovoltai, duke minimizuar kështu ndikimet shtesë në mjedis dhe në komunitetin përreth.

2.11 Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Pëlqimi mjedisor

→ Dokument zyrtar i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), i cili vërteton se projekti i plotëson kriteret mjedisore dhe mund të vazhdojë në fazat e ndërtimit dhe operimit; ky dokument merret pas përfundimit të procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe zakonisht paraprin lejet e tjera;

Leja mjedisore

→ Dokument zyrtar i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), i cili përcakton kushtet dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së operimit të projektit; për të marrë këtë leje operatori duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi, pas së cilës autoriteti kompetent zhvillon shqyrtim administrativ dhe teknik, përfshirë edhe verifikim në terren; vendimi për dhënien ose refuzimin e lejes merret pas vlerësimit të përputhshmërisë së projektit me kërkesat mjedisore dhe leja zakonisht lëshohet për një periudhë të kufizuar kohore (p.sh. 5 vite), duke përfshirë detyrime për monitorim dhe raportim.

Kushtet ndërtimore

→ Dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti komunal kompetent (Drejtoria për Urbanizëm/Planifikim Hapësinor), i cili përcakton parametrat urbanistikë dhe kushtet teknike për zhvillimin e projektit në një parcelë të caktuar; ky dokument përbën fazën e parë të procedurës për leje ndërtimore dhe përfshin përcaktimin e destinimit të tokës, kushteve të ndërtimit, qasjes infrastrukturore dhe kërkesave të tjera relevante; kushtet ndërtimore janë të vlefshme për një periudhë të kufizuar dhe shërbejnë si bazë për hartimin e projektit kryesor dhe aplikimin për leje ndërtimore.

Leja ndërtimore

→ Dokument zyrtar i lëshuar nga autoriteti komunal kompetent (Drejtoria për Urbanizëm/Ndërtim), i cili autorizon fillimin e punimeve ndërtimore në përputhje me projektin e aprovuar; kjo leje përbën fazën e dytë të procedurës së ndërtimit dhe lëshohet pasi projekti të ketë përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe teknike, përfshirë sigurimin e pëlqimit mjedisor, kushteve ndërtimore dhe dokumentacionit teknik; leja ndërtimore përcakton kushtet për realizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve dhe zakonisht duhet të shfrytëzohet brenda një periudhe të caktuar, përndryshe humbet vlefshmërinë.

Përputhshmëria me planet komunale

→ Verifikimi i përputhshmërisë me PZHK/Hartën Zonale nga Komuna e Obiliqit (për të konfirmuar se projekti lejohet sipas planifikimit hapësinor).

Pëlqime dhe autorizime shtesë që mund të kërkohen gjatë zbatimit (varësisht nga dizajni final dhe kërkesat institucionale)

Marrëveshja për kyçje në rrjet – sigurohet nga operatori i rrjetit, duke përcaktuar kushtet teknike për lidhjen dhe operimin e sistemit;

→ KEDS: jep informatën teknike për kyçje dhe ofron marrëveshjen e kyçjes në rrjet (varësisht nga niveli/pika e kyçjes).

Përveç lejeve/licencave kryesore të mësipërme, në praktikë kërkohen edhe pëlqime/autorizime shtesë, sidomos për ndërhyrje në infrastrukturë publike, siguri dhe komunikime:

→ Ministria e Kulturës / IKMM (Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve) – Pëlqimi sipas kërkesave nga Ligji për Trashëgimi Kulturor për punë ndërtimore brenda perimetrit të trashëgimisë kulturore

→ Pëlqim lidhur me sigurinë nga zjarri, masat emergjente dhe elemente të tjera të sigurisë (sipas kërkesave teknike të projektit) nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME)

→ Pëlqime për qasje në infrastrukturë publike

2.12 Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti nuk paraqet ndërlidhje direkte me projekte të tjera ndërtimore apo infrastrukturore në zonë, pasi realizohet brenda një objekti ekzistues dhe nuk kërkon zgjerim të territorit apo ndërhyrje në hapësira të reja. Megjithatë, në mënyrë indirekte, ai mund të lidhet me iniciativa dhe politika kombëtare për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme dhe për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.

Në aspektin kumulativ, projekti mund të konsiderohet si pjesë e zhvillimeve të përgjithshme në sektorin e energjisë së pastër, duke u integruar me projekte të tjera të ngjashme në nivel lokal apo kombëtar, pa krijuar ndërveprime negative apo mbivendosje të ndikimeve mjedisore.

Në tërësi, ndërlidhjet e projektit janë kryesisht funksionale dhe pozitive, duke kontribuar në optimizimin e përdorimit të energjisë dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik.

3 PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1 Të dhëna për lokacionin ku është planifikuar të zbatohet projekti

Lokacioni i projektit gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në rajonin e Prishtinës, në territorin administrativ të komunës së Obiliqit, zona kadastrale Llazarevë.

3.2 Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Lokacioni i projektit ndodhet në zonën kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit. Koordinatat e lokacionit janë: 42.718127111427286 V, 21.09782934278425 L, numri i njësisë kadastrale është: P-72614041-00138-3.



Figura 1. Njësia kadastrale ku ndodhet objekti i Ritek Construction (burimi: gjeoportali)




Figura 2. Lokacioni i objektit industrial Ritek Construction ku do të instalohet sistemi solar fotovoltaik

3.3 Distanca me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Lokacioni i projektit ndodhet në objektin e Ritek Construction, zona kadastrale Llazarevë, komuna e Obiliqit, në një zonë me karakter të përzier industrial dhe pjesërisht rezidencial. Duke qenë se projekti realizohet në kulmin e një objekti ekzistues, është me rëndësi të theksohen objektet dhe njësitë e banuara më të afërta në raport me këtë lokacion.

Objektet më të afërta në raport me lokacionin e projektit janë kryesisht ndërtesa industriale dhe objekte ndihmëse që i përkasin zonës ku operon Ritek Construction, të cilat ndodhen në distancë shumë të afërt, brenda të njëjtit kompleks apo në afërsi prej disa dhjetëra metrash.

Sa i përket objekteve të banimit, shtëpitë individuale më të afërta ndodhen në periferi të zonës industriale, në një distancë të përafërt prej rreth 100 deri në 300 metra nga objekti ku planifikohet instalimi i sistemit fotovoltaik. Këto janë kryesisht banesa individuale të shpërndara, që nuk përbëjnë një zonë të dendur urbane.

Në distanca pak më të mëdha, rreth 300 deri në 500 metra, ndodhen grupe të tjera të banimit brenda fshatit Milloshevë, të cilat përfaqësojnë zonën më të afërt të konsoliduar të banimit.

Duke marrë parasysh se projekti zhvillohet në kulm dhe nuk përfshin procese ndotëse gjatë operimit, si dhe duke pasur parasysh distancën ekzistuese nga objektet e banimit, nuk priten ndikime të rëndësishme ndaj popullsisë përreth. Pozicionimi i projektit brenda një zone ekzistuese industriale kontribuon më tej në minimizimin e ndërveprimit me zonat rezidenciale.

Në tërësi, lokacioni i projektit ka një distancë të përshtatshme nga objektet e banimit më të afërta dhe konsiderohet i favorshëm nga aspekti i ndikimeve potenciale në komunitetin përreth.



Figura 3. Lokacioni i fabrikës Ritek Construction dhe mjedisi rrethues

3.4 Paraqitja e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Përbërja pedologjike

Paleozoiku (Pz) – është i përfaqësuar me Rreshpet kristalin (që janë të përfaqësuara me argjiloshiste, filite dhe rrallë herë me rreshpe amfibolike) dhe Gëlqerorët kristalin (që në shumicën e rasteve shtrihen mbi rreshpe, kurse pjesa më e vogël e tyre gjendet në mesin e serisë rreshpore). Gëlqerorët kristalin ndodhen në pjesën e skajshme perëndimore të zonës, në anët lindore të Malit të Qyqavicës, dhe janë të shpërndarë në formë të thjerrëzave të shumta. Në grupe të vogla gëlqerorët janë të

silifikuar deri në atë masë sa me vështirësi dallohen nga filitet dhe kuarcitet. Në rreshtet kristalin dhe gëlqerorët kristalin deri më tani nuk është gjetur fauna, dhe nga kjo çështja e moshës së tyre është mbetur e hapur.

Mezozoiku (Mz) – është i përfaqësuar nga Serpentinitet, Flishi i Kretakut të Sipërm dhe Gëlqerorët. Serpentinitet dhe Peridotitet paraqiten në disa zona të radhitura në drejtimin V-VP –dhe J-JL. Masa të vogla paraqiten edhe në JP të fshatit Sibovc, përkatësisht në vijën kryesore shkarëse, përgjatë të cilës është formuar pellgu i Kosovës.

Kenozoiku (Kz) - është i përfaqësuar nga sedimentet e Terciarit dhe të Kuaternarit. Terciari (Tc), përfaqësohet nga shkëmbinjtë andezito – dacit dhe tufet, si dhe sedimentet e Neogjenit (Ng).

Kuaternari (Q), në pjesën më të madhe është i përfaqësuar me rëra aluviale dhe zhavorre.¹




Figura 4. Përbërja pedologjike e komunës së Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)

Gjeologjia dhe tokat

Sa përket përbërjes gjeologjike të tokës në territorin e komunës, me 43.98% dominon përbërja balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht e linjtit, pastaj 21.79% është përbërje lymore dhe 12.04% është përbërje proluvium.

Tabela 1. Veçoritë gjeologjike

Kategoritë gjeologjike	Sipërfaqja (ha)	%
Albite diorite	4.57	0.04

¹ Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit

Alluvium	1098	10.47
Balta, rëra, zhavorri, marlina, pjesërisht linjit	4611	43.98
Diabase, spilite, bazalt	4.86	0.05
Gabro	17.65	0.17
Heterogeneous breccia	31.74	0.30
Sedimentet e liqenit dhe lumenjve	20.46	0.20
Mermer	17.94	0.17
Mermer, rreshpe gëlqerore	116.4	1.11
Gur mermeri, gur ranor, gur gëlqeror, tuffite, pjesërisht linjit	65.15	0.62
Micaquartzite, metasandstone, metamudstone	34.38	0.33
Proluvium	1262	12.04
Pyroclastite, lappilli, breccia	180.8	1.72
Quartzite, metaquartzsandstone, conglomerate	17.09	0.16
Reeflimestone, breccias, sandy flysch with olistoliths	58.19	0.56
Lymore	2285	21.79
Sandstone, phyllite, marble, calcareous schist	49.57	0.47
Sandstone, siltstone, marlstone	56.08	0.53
Serpentine	34.89	0.33
Volcanic-sedimentary series	518.5	0.53




Figura 5. Formacionet gjeologjike në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)

Karakteristikat hidrografike

Në territorin e komunës së Obiliqit ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: Sitnica, Drenica dhe Llap. Ka edhe një kanal artificial që është Kanali Ibër - Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit Ibër. Lumi Sitnica përshkon territorin e komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80% të ujërave në drejtim të veriut. Lumi Sitnica derdhet në lumin Ibër në Mitrovicë. Lumi Drenica rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin Sitnicë para hyrjes në jug në territorin e komunës. Lumi Llap rrjedhë në lindje, i cili derdhet në lumin Sitnicë në veri të territorit të komunës. Lumi Sitnica është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m³/s, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkrirja e borës, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m³/s. Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi Sitnica del jashtë shtratit dhe përmbytë sipërfaqe të tokave punuese përreth, duke i shkaktuar dëme të mëdha bujqësisë. Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të lumit Sitnicë në lindje dhe dy në drejtim të lumit Drenica në perëndim. Përgjatë lumit Sitnica shtrihet një fushë, që përmbytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy blloqet e TC Kosova B.²

² Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit




Figura 6. Rrjeti hidrografik në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)

Sizmologjia

Territori i komunës është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikrosizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore. Kosova i nënshtrohet lëvizjeve tektonike vertikale dhe është në një zonë aktive sizmike të shtrirë përgjatë Rripit Orogjenik - Alpine - Himalaje. Në hartën e mëposhtme paraqiten zonat me shkallë sizmike në Kosovë bazuar në magnitudat që janë vëzhguar deri me tani me epiqendrat e tërmetejeve të regjistruara gjatë periudhës një shekullor.




Figura 7. Shtrirja e zonave në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)

3.5 Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Në komunën e Obiliqit ekzistojnë dy sisteme për furnizim me ujë cilësor të pijes: Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KRU “Prishtina” e që furnizon 70% të zonës urbane të Obiliqit dhe tetë vendbanime tjera rurale me ujë, një sistem tjetër (puset në Obiliqin e Vjetër) që menaxhohet nga KRU “Prishtina” që furnizon 30% të zonës urbane të Obiliqit, dhe pesë vendbanime tjera rurale, dhe disa vendbanime nga burimet nëntokësore nga bunarët individual, të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes.

Vendbanimet e mëposhtme që furnizohen me ujësjellës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjetër, Mazgiti i Ulët, Mazgiti i Epërm, Millosheva, Llazareva, Baskia, Baimofci, Breznica, Plemetini, Hamidi, Sibovci, Hade, Dobrosellë, Leshkoshin, Cërkena Vodice, dhe Kryshefc.³

Projekti nuk ka kërkesa të konsiderueshme për ujë, pasi procesi i prodhimit të energjisë elektrike bazohet në shfrytëzimin e rrezatimit diellor dhe nuk përfshin procese teknologjike që kërkojnë përdorim të vazhdueshëm të ujit.

Nevoja për ujë lidhet kryesisht me aktivitetet e mirëmbajtjes së sistemit, konkretisht me pastrimin periodik të paneleve fotovoltaike për të siguruar efikasitet optimal të prodhimit të energjisë. Pastrimi i paneleve realizohet në intervale të caktuara, në varësi të kushteve atmosferike dhe nivelit të pluhurit apo ndotjes në sipërfaqen e tyre. Konsumi i ujit për këtë qëllim është i kufizuar dhe nuk paraqet ngarkesë të konsiderueshme për burimet ujore. Gjatë fazës së instalimit mund të ketë nevojë minimale

³ Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit

për ujë, kryesisht për qëllime të përgjithshme si pastrim i sipërfaqeve apo përdorim nga stafi, por këto kërkesa janë shumë të ulëta dhe të përkohshme.

3.6 Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Klima e Kosovës është në pjesën më të madhe kontinentale, duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë me ndikime Mesdhetare dhe Alpine (temperatura mesatare brenda vendit luhetet nga + 30 °C (verë) në – 10 °C (dimër)). Megjithatë, për shkak të ngritjeve të pabarabarta në disa pjesë të vendit, ka ndryshime në temperaturë dhe shpërndarjen e reshjeve. Dhjetori dhe Janari janë konsideruar si muajt më të ftohtë. Korriku dhe Gushti, si muajt më të ngrohtë të vitit. Sasia maksimale e reshjeve është arritur ndërmjet Tetorit dhe Dhjetorit. Ndërmjet Nëntorit dhe Marsit, në Kosovë mund të bie dëborë, madje dhe në pjesët e sheshta të vendit. Sasia më e madhe e reshjeve mund të bie në rajonet malore të Kosovës. Lugina midis Mitrovicës dhe Kaçanikut i përket zonës më të thatë të vendit. Në kontrast me të, fusha e Dukagjinit midis Pejës dhe Prizrenit është përshkruar si një zonë shumë pjellore me më shumë reshje midis Nëntorit dhe Marsit.

Bazuar nga kushtet klimatike, Kosova mund të ndahet në tri zona klimatike si më poshtë:

1. Zona klimatike e Kosovës (Rrafshi i Kosovës),
2. Zona klimatike e Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit) dhe
3. Zona klimatike e maleve dhe e pjesëve të pyllëzuara.

Zona klimatike e Kosovës (Rrafshi i Kosovës), që përfshin luginën e Ibrit është e ndikuar nga masa ajri kontinentale. Për këtë arsye në këtë pjesë të vendit dimrat janë më të ftohtë me temperatura mesatare mbi – 10 °C, por ndonjëherë nën – 26 °C. Verat janë shumë të nxehta, me temperaturë mesatare 20 °C, disa herë mbi 37 °C. Kjo zonë është e karakterizuar nga një klimë e thatë dhe reshje vjetore totale afërsisht 600 mm në vit.

Zona klimatike e Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit), që përfshin kurrizin ujëndarës të lumit Drini i Bardhë, është i ndikuar shumë nga masa ajri të nxehta, që përshkoi Detin Adriatik. Temperaturat mesatare gjatë dimrit luhaten nga 0.5 °C deri në 22.8 °C. Reshjet vjetore mesatare të kësaj zone klimatike janë 700 mm për vit. Dimri është i karakterizuar nga reshje të forta dëbore.

Zona klimatike e maleve dhe e pjesëve të pyllëzuara në Kosovë ka temperatura mesatare që luhaten nga -5°C gjatë dimrit deri në rreth 20°C gjatë verës. Dimrat janë të gjatë dhe të ftohtë, ndërsa verat janë të freskëta. Reshjet në këto zona janë më të larta se në ultësira, me një mesatare vjetore që arrin deri në 1000-1500 mm, duke përfshirë reshje bore të konsiderueshme gjatë dimrit.

Dielllosja

Në komunën e Obiliqit ka ekspozicion qendror si komunë ku dominon relievi kodrinor-malor që përfshin lindjen, perëndimin dhe pjesa qendrore e komunës është pjesë fushore që shtrihet rreth Lumit Sitnica. Kodrat janë me pjerrtësi më të ulët, përveç në lindje dhe perëndim ku pjerrtësia është relativisht më e madhe. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), relievi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat.




Figura 8. Pjerrtësia e terrenit në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)




Figura 9. Ditët me diell, shi dhe reshje në komunën e Obiliqit⁴

Temperatura

Në komunën e Obiliqit temperatura mesatare vjetore është 10.2°C, përderisa muaji më i ftohtë është Janari me -1.5°C, ndërsa muaji më i nxehtë është Gushti, me temperaturë mesatare vjetore 20.5°C. Në regjimin e reshjeve atmosferike të kësaj zone dhe rrethinës, ndikim parësor kanë aktivitetet ciklonike

⁴ https://www.meteoblue.com/en/weather/historyclimate/climatemodelled/obiliq_kosovo_787534

me prejardhje të ndryshme, të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga jugu, nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit, si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga veriu dhe verilindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810mm.




Figura 10. Temperatura mesatare dhe reshjet në komunën e Obiliqit⁵

Era

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre, mund të konstatohet se qetësitë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7%. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga:

- Veri-Verilindja me 20.3%;
- Veriu me 19.4% ;
- Perëndimi me 4 %; dhe
- Jugu me 5%.

Era nga drejtimi verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin gusht e më së paku në muajin prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit mars në shumë vite, dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin shtator 1.8 m/sekondë.

⁵ https://www.meteoblue.com/en/weather/historyclimate/climatemodelled/obiliq_kosovo_787534




Figura 11. Trëndafili i erës

3.7 Prezantimi i karakteristikave natyrore

Zona ku është planifikuar të zbatohet projekti karakterizohet nga një peizazh tipik i pjesës qendrore të Kosovës, me relief kryesisht fushor dhe lehtësisht kodrinor. Kjo zonë bën pjesë në Rrafshin e Kosovës, i cili është një nga njësitë kryesore gjeografike të vendit dhe shquhet për terren relativisht të rrafshët dhe të përshtatshëm për zhvillime industriale dhe infrastrukturore.

Peizazhi përreth lokacionit të projektit dominohet nga sipërfaqe të hapura, toka bujqësore dhe zona të zhvilluara industriale, ndërsa elementet natyrore si pyjet dhe zonat malore janë të kufizuara në afërsi të drejtpërdrejtë të projektit. Zonat më të theksuara malore dhe pyjore ndodhen në distanca më të mëdha nga lokacioni, jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë të projektit.

Sa i përket mbulesës bimore, zona karakterizohet nga vegjetacion i ulët dhe sipërfaqe të kultivuara bujqësore, ndërsa në disa pjesë mund të hasen edhe grupe të vogla pemësh apo bimësi spontane përgjatë rrugëve dhe parcelave. Nuk identifikohen habitate të ndjeshme natyrore apo zona të mbrojtura në afërsi të menjëhershme të lokacionit.

Nga aspekti hidrografik, zona nuk karakterizohet nga prania e trupave të mëdhenj ujorë në afërsi të drejtpërdrejtë të objektit të projektit, ndërsa rrjedhat ujore eventuale janë të karakterit lokal dhe nuk ndikohen nga zhvillimi i projektit, duke qenë se ndërhyrja realizohet në kulm të një objekti ekzistues.

Në tërësi, karakteristikat natyrore të zonës së projektit tregojnë një mjedis të transformuar në masë të konsiderueshme nga aktivitetet njerëzore, me dominim të përdorimeve industriale dhe bujqësore, dhe me mungesë të elementeve të ndjeshme natyrore në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit. Kjo e bën zonën të përshtatshme për zhvillimin e projekteve të tilla me ndikim të ulët në mjedis.

Zonat e mbrojtura natyrore

Komuna e Obiliqit karakterizohet me një trashëgimi natyrore shumë të pasur. Në komunë janë identifikuar gjithsejtë 9 asete të trashëgimisë natyrore. Nga asetet e trashëgimisë natyrore të vetëm trungjet e dushkut, të blirit dhe guri në Sibovc, janë të shpallura nën mbrojtje nga niveli qendror, gjersa

Maja e Zezë –Grabofc i Epërm, Bota e kuqe dhe gurët e gjelbër në Grabofc të Epërm, Kroi i Mjekiqve, Burimi i ujit mineral në Grabofc të Epërm, Çeshmja e katundit në Palaj, Bunari/Çeshmja e Mulla Jahës në lagjen e Hashanëve, Bunari i Pashës dhe Bunari i Dashnisë, janë të identifikuara nën mbrojtje nga komuna, mirëpo nuk janë të shpallura nën mbrojtje nga institucionet qeveritare të nivelit qendror.

Megjithatë, të gjitha këto zona dhe vlera të mbrojtura apo të identifikuara gjenden në distancë dhe nuk preken nga zhvillimi i projektit, duke mos u parashikuar ndikime direkte apo indirekte mbi to.

Zonat me popullsi të dendur

Zona ku planifikohet të zbatohet projekti nuk karakterizohet nga densiteti i lartë i popullsisë në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit. Vetë lokacioni i projektit ndodhet në një zonë me karakter kryesisht industrial dhe me shpërndarje të rrallë të banesave, ku nuk ka koncentrim të mëdha të popullsisë.

Zonat me popullsi më të dendur në raport me lokacionin e projektit gjenden në distanca më të mëdha, kryesisht në qendrat urbane përreth. Qyteti i Obiliqit përfaqëson zonën më të afërt urbane me densitet më të lartë të popullsisë, ndërsa qyteti i Prishtinës, si kryeqytet, paraqet zonën me densitetin më të lartë në rajon, por ndodhet në një distancë më të konsiderueshme nga lokacioni i projektit.

Brenda vetë fshatit Milloshevë, popullsia është e shpërndarë dhe nuk ka zona të konsoliduara me dendësi të lartë banimi në afërsi të menjëhershme të objektit të projektit. Banesat janë kryesisht individuale dhe të shpërndara, duke krijuar një mjedis me densitet të ulët deri mesatar të popullsisë.

Duke marrë parasysh këtë shpërndarje hapësinore të popullsisë, projekti nuk ndodhet në afërsi të zonave me popullsi të dendur dhe nuk pritet të ketë ndikime të konsiderueshme sociale apo mjedisore mbi komunitetet me densitet të lartë banimi. Pozicionimi i tij në një zonë industriale kontribuon më tej në minimizimin e ndërveprimit me këto zona.

3.8 Rishikimi i karakteristikave themelore të peisazhit

Peizazhi në zonën ku planifikohet të zbatohet projekti paraqet një kombinim të elementeve natyrore dhe atyre të modifikuara nga aktivitetet njerëzore, me dominim të përdorimeve industriale dhe bujqësore. Zona bën pjesë në Rrafshin e Kosovës, i cili karakterizohet nga reliev kryesisht i rrafshët me variacione të lehta kodrinore, duke krijuar një peizazh të hapur dhe të ekspozuar.

Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit të projektit, peizazhi dominohet nga objekte industriale, infrastrukturë energjetike dhe sipërfaqe të përdorura për aktivitete ekonomike. Prania e këtyre elementeve e ka transformuar ndjeshëm karakterin natyror të zonës, duke e bërë atë një mjedis të zhvilluar dhe të përshtatur për funksione industriale.

Elementet natyrore të peizazhit përfshijnë sipërfaqe të hapura bujqësore, vegjetacion të ulët dhe në disa raste grupe të shpërndara pemësh. Nuk identifikohen zona të mëdha pyjore apo elemente të theksuara malore në afërsi të menjëhershme të projektit, ndërsa horizonti i peizazhit mbetet i hapur dhe me pengesa të kufizuara vizuale.

Nga aspekti vizual, projekti i propozuar, duke qenë i vendosur në kulmin e një objekti ekzistues, nuk pritet të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme karakterin e peizazhit. Panelet fotovoltaike do të integrohen në strukturën ekzistuese të ndërtesës dhe do të jenë në përputhje me përdorimin aktual të zonës. Ndikimi vizual konsiderohet i ulët, pasi instalimi nuk përfshin struktura të reja të larta apo ndërhyrje në terren.

Në tërësi, peizazhi i zonës së projektit është tashmë i modifikuar nga aktivitetet industriale dhe infrastrukture, dhe projekti i propozuar nuk pritet të shkaktojë ndryshime të rëndësishme në karakteristikat themelore të tij.

3.9 Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale. Në disa pjesë të Komunës së Obiliq ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Qyqavicës, midis fshatrave Graboc i Epërm, Shipitullë e Sibovc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar. Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në territorin e Komunës.

Në Komunën e Obiliqit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka përfshirë në mbrojtje të përkohshme:⁶

- Lokalitet arkeologjik parahistorik shumëshresor në Dardhishtë;
- Tyrbja e Sulltan Muratit;
- Sellamllëku;
- Mulliri i Berhramjave, Graboc i epërm;

3.10 Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Kosova kishte një popullsi prej 1,585,566 banorë të regjistruar në vitin 2024. Kosova ka një dendësi të popullsisë prej 146 banorë për kilometër katror. Me regjistrimin e vitit 2024, komuna e Obiliqit ka një popullsi prej 22,815 banorësh rezident.⁷ Sipas PZHK lokacioni i projektit, zona kadastrale Llazarevë, ka një popullsi prej 429 banorësh.

3.11 Të dhëna për objekte ekzistuese

Në lokacionin ku planifikohet të zbatohet projekti, konkretisht në objektin e Ritek Construction në komuna e Obiliqit, ekzistojnë objekte dhe infrastrukturë që i përkasin një zone me karakter industrial. Objekti kryesor është ndërtesa industriale e kompanisë, e cila shërben për aktivitetet e saj prodhuese dhe logjistike, dhe në kulmin e së cilës parashihet të instalohet sistemi solar fotovoltai.

Në afërsi të menjëhershme të lokacionit ndodhen edhe objekte të tjera industriale dhe biznese, si dhe infrastrukturë energjetike dhe rrugore që mundëson qasje të lehtë dhe lidhje me rrjetin më të gjerë. Në distanca më të afërta gjenden edhe disa objekte banimi individuale, të shpërndara në periferi të zonës industriale.

Projekti i propozuar nuk parashikon ndërtimin e objekteve të reja, por shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese të ndërtesës për instalimin e paneleve fotovoltaike. Si i tillë, ndërhyrja në objektet ekzistuese është minimale dhe kufizohet në instalimin e strukturave mbajtëse dhe pajisjeve teknike në kulm, si dhe në integrimin e sistemit me rrjetin elektrik të brendshëm.

⁶ Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2023-2024

⁷ ASK – Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024

Në tërësi, prania e objekteve ekzistuese industriale dhe infrastrukturës mbështetëse e bën lokacionin të përshtatshëm për realizimin e projektit, duke reduktuar nevojën për ndërhyrje të reja ndërtimore dhe ndikimet e mundshme në mjedis.

3.12 Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Në bazë të shqyrtimit të karakteristikave të lokacionit dhe të dhënave ekzistuese për zonën e projektit, nuk identifikohen zona të përcaktuara për kërkime shkencore, vende arkeologjike të regjistruara brenda kufijve të zonës së projektit, si dhe nuk ka zona të veçanta të ndjeshme ose zona me qëllime të veçanta që mund të ndikohen drejtpërdrejt nga aktivitetet e planifikuara. Gjithashtu, nuk janë evidentuar struktura apo lokalitete të mbrojtura arkeologjike në hapësirën e projektit, ndërsa çdo potencial për gjetje të rastësishme gjatë punimeve do të trajtohet në përputhje me procedurat ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

3.13 Të dhënat për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj

Bazuar në të dhënat e disponueshme nga hartat gjeohapësinore në sipërfaqen ku planifikohet të realizohet projekti nuk identifikohen burime ujore sipërfaqësore si lumenj, liqene apo kanale ujitëse. Projekti zhvillohet në kulmin e një objekti ekzistues industrial, çka nënkupton se ndërhyrja nuk prek drejtpërdrejt tokën apo ndonjë trup uJOR.

Në afërsi të gjerë të lokacionit, zona e Obiliqit karakterizohet nga prania e disa rrjedhave ujore të vogla dhe kanaleve kulluese që shërbejnë për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe bujqësore. Një nga rrjedhat ujore më të rëndësishme në rajon është lumi Sitnica, i cili kalon në një distancë më të madhe nga lokacioni i projektit dhe nuk ndikohet nga aktivitetet e propozuara.

4 GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

Ky kapitull paraqet gjendjen ekzistuese të faktorëve mjedisorë në zonën ku planifikohet realizimi i projektit, me qëllim përcaktimin e kushteve bazë dhe vlerësimin e ndjeshmërisë së receptorëve mjedisorë që mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit. Përshkrimi i mëposhtëm bazohet në të dhënat ekzistuese për zonën e projektit dhe hapësirën përreth saj, si dhe në vëzhgimet e kryera në terren, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes mjedisore aktuale.

4.1 Përshkrimi i gjendjes aktuale të faktorëve mjedisor

Territori i komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 104.84 km² dhe zë një hapësirë rreth 1% të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica dhe lumit Llap, ndërsa pjesët tjera të relievit në përfundim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).

Komuna e Obiliqit duke qenë e vendosur në fushëgropën e Kosovës, sikur mbahet mbi supet e maleve të Qyqavicës dhe Shalës së Bajgorës. Kjo komunë përshkon tërëthorazi këtë fushëgropë prandaj edhe

ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore prej 1,0531 ha, që përbën 48% e territorit të komunës së Obiliqit, gjersa 37% është tokë pyjore.

Cilësia e ajrit

Zonat me ndotjen më të madhe të ajrit në komunën e Obiliqit janë në rreze prej 8 km nga zona industriale dhe përfshijnë këto vendbanime: Kryshefc, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Cërkvëna Vodicë dhe Lajthishtë. Procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga termoelektranat përcillet me emetim të pluhurit dhe gazrave siç janë: SO₂, NO_x, CO, CO₂, H₂S, bloza, thërrmijat ajrore, sendimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj).

Tabela 2. Vlerat e parametrave të ajrit të matur në stacionin në Obiliq, viti 2024

Stacioni	Muaji	PM10	PM2.5	NO ₂	O ₃	SO ₂	CO
	Janar	34.9	31.5	13.8	34	22.2	1.4
	Shkurt	30.2	24.7	12.2	37.8	9.3	1.2
	Mars	18.9	13.7	8.9	49.5	5.5	0.9
	Prill	16.7	10	7.9	57.8	8.5	0.9
	Maj	9	6.4	5.1	55.8	12.1	0.8
Obiliq	Qershor	12.1	6.8	5.8	60.1	14.1	0.8
	Korrik	13.9	8.2	8.1	70.3	18.3	0.8
	Gusht	13.5	8.2	9.2	70.7	12	0.5
	Shtator	16.4	9.2	7.8	42.6	0.9	0.6
	Tetor	21.9	15.4	9.5	24.7	9.9	0.7
	Nëntor	30.8	27	12.2	20.1	12.3	1.5
	Dhjetor	32.2	25	10.9	19.7	11.1	1.5

Zhurma

Sa i përket ndotjes akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Aktivitetet minerare, transporti i thëngjillit, pajisjet për eskavim dhe shiritat bartës janë ndër faktorët kryesor që shkaktjnë ndotje akustike në komunë. Burim tjetër i ndotjes akustike është edhe termocentrali Kosova A dhe operacionet që ndërlidhen me TC-në.

Cilësia e ujërave

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Obiliqit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edhe ku ka shtrirje të aktiviteteteve njerëzore.

Obiliqi është qytet i rrethuar me shumë fshatra dhe thua se i gjithë qyteti dhe fshatrat kanë të ndërtuar sistemin e kanalizimit, ku shkarkimet e ujërave të zeza bëhen kryesisht në lumin Sitnicë dhe në disa përroska të afërta.

Erozioni

Edhe në territorin e Obiliqit është prezente dukuria e erozionit, që rrezikon me humbje të tokës bujqësore dhe dëme të tjra në ekonominë familjare. Në bazë të të dhënave, nga shkalla e lartë e rrezikshmërisë erozive janë përfshirë rreth 535 ha ose 6 % e sipërfaqes së territorit të komunës, ku shkalla e rrezikshmërisë është në rritje nga faktorët natyror dhe faktori njeri.




Figura 12. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit në komunën e Obiliqit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031 i komunës së Obiliqit)

Përmbajtjet

Lumi i Sitnicës është lum fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime. Lumi Drenica rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin Sitnicë para hyrjes në jug në territorin e komunës së Obiliqit. Ndërsa, lumi Llap, rrjedhë në lindje dhe derdhet në lumin Sitnicë në veri të territorit.

Përveç dëmeve materiale, lumi Sitnicë është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termoparket dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direct, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit. Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza.

Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jazë 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe kënetë 3.08 ha. Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Obiliqi, Kryshefc, Cërkvena Vodice, Plemetini dhe Hamidija. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap. Përveç faktorëve natyror edhe faktori njeri ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet përmes disa aktiviteteve si:

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve)
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë rritura pranë brigjeve të lumenjve, etj.
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat), etj.




